

OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT dhe TREGUT – KOSTT J.S.C

Pasqyrat Financiare

31 Dhjetor 2010

(Me raportin e auditorëve të pavarur bashkëlidhur)

PËRMBAJTJA:

	Page
Raporti i auditoreve të pavarur	i-iv
Pasqyrat financiare:	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse	2
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit	3
Pasqyra e rrjedhjes se parase	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare	5 – 26



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Telephone +381(38) 246 771
Telefax +381 (38) 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve te pavarur

Bordit Drejtues të
Operatorit te Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT

Prishtine, 3 Qershor 2011

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Operatorit te Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT J.S.C ("Shoqeria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e gjendjes financiare e datës 31 dhjetor 2010, pasqyra përmbledhëse të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e rrjedhës së parave për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe kontrollin e brendshme të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qellim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyre që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qellim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmerinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marre është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin e auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare të Shoqërisë me 31 dhjetor 2010, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Cështje e theksuar

Pa kualifikuar raportin tonë, ne tërheqim vëmendjen të nota 23 (i) e pasqyrave financiare, ku ekziston një shkallë pasigurie për shlyerjen finale të shumave prej 4,215 mijë Euro të cilat janë detyrime ndaj Elektomreza Serbije dhe janë njohur në detyrime tregtare dhe detyrime të tjera, ndërsa faturat për të hyrat për shërbime ndaj Elektomreza Serbije, të cilat kanë arritur shumën prej 10,373 mijë Euro, nuk janë regjistruara në këto pasqyra financiare. Në të dy rastet zgjidhja përfundimtare është e varur nga negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Cështje tjetër

Pasqyrat financiare të Shoqërisë me dhe për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2009 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka dhënë një opinion të pa modifikuar me 13 maj 2010.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k, - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovoo

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C

Pasqyra e Pozicionit Financiar në 31 Dhjetor 2010

(në EUR)


	Shëni me	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
AKTIVI			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	88,791	75,195
Aktive afatgjata jo materiale	7	36	46
		88,827	75,241
Aktive afatshkurtra			
Inventarët	9	908	1,016
Të arkëtueshme dhe të tjera	10	9,390	10,202
Parapagime furnitorëve	8	6,887	8,502
Mjete monetare në arkë e bankë	11	14,850	9,137
		32,035	28,857
Totali i aktivitet		120,862	104,098
KAPITALI			
Kapitali aksioner	12	25	25
Prim i aksioneve	12	28,347	28,347
Fitime të bartura		10,617	3,853
Fitimi i periudhës		3,468	6,764
Totali i kapitalit		42,457	38,989
DETYRIME			
Detyrime afatgjata			
Grante qeveritare	13	68,392	57,362
		68,392	57,362
Detyrime afatshkurtra			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	14	8,671	7,097
Detyrim i tatimit të periudhës	21	157	481
Detyrim i tatimit të shtyrë		185	169
		9,013	7,747
Totali i detyrimeve		78,405	65,109
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		120,862	104,098

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve më 3 Prill 2011 dhe janë firmosur në emër të Bordit nga:

Kryeshëfi Ekzekutiv

Fadil Ismaili



Zyrtari kryesor financiar

Nebih Haziri



Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C

Pasqyra e të ardhurave përmblëdhëse për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010

(në EUR)

	Shëni me	2010	2009
Të ardhura			
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	15	20,076	20,061
Të ardhura të tjera	16	2,348	977
		22,424	(21,038)
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	17	(2,736)	(2,338)
Amortizimi dhe zhvleresimi	6,7	(4,866)	(3,001)
Riparime dhe mirëmbajtje	18	(752)	(918)
Humbje në transmisionin e energjisë		(4,319)	(5,212)
Shpenzimet e tjera operative	19	(4,121)	(1,258)
Rregullim dytësor		(1,600)	(996)
Shpenzime për lëndë djegëse		(190)	(79)
		(18,584)	(13,802)
Fitimi operativ			
Të ardhura interesi	20	301	219
		4,141	7,455
Fitimi para tatimit			
Tatimi mbi fitimin	21	(673)	691
		3,468	6,764
Fitimi neto i periudhës			
Të ardhura të tjera përmblëdhëse, neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali i të ardhurave përmblëdhëse për vitin		3,468	6,764

Pasqyra e të ardhurave përmblëdhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit në 31 Dhjetor 2010

(në EUR)

	Kapitali aksioner	Prim i aksioneve	Fitime të mbartura	Totali
Gjendje më 1 Janar 2009	25	28,347	3,853	32,225
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin				
Fitimi për periudhën	-	-	6,764	6,764
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	6,764	6,764
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	25	28,347	10,617	38,989
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin				
Fitimi për periudhën	-	-	3,468	3,468
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	-	-	3,468	3,468
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	25	28,347	14,085	42,457

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi neto i periudhës		3,469	6,764
<i>Rregullime për te rekonciliuar ndryshimet e aktiveve neto në para neto nga aktivitetet operative:</i>			
Amortizimi dhe zhvleresimi	6,7	4,886	3,001
Të ardhurat nga interesi	20	(301)	(219)
Nxjerrje nga përdorimi e aktiveve afatgjata materiale	6	8	18
Të ardhura të shtyra nga grantet		(1,828)	(890)
		6,214	8,764
Rrjedhja e parasë nga fitimi operativ para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative			
<i>(Rritje)/rënie në aktivet operative:</i>			
Inventarë		108	241
Të arkëtueshme dhe të tjera		812	(2,624)
Parapagime ndaj furnitorëve		1,615	2,001
Të pagueshme dhe të tjera		1,574	2,305
Detyrim i tatimit të periudhës		(324)	481
Detyrimi për tatimin e shtyrë		16	169
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operative		10,015	11,247
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	6,7	(18,460)	(34,904)
Interesi i marrë		301	219
Flukset neto të parasë të përdorura në aktivitetet investuese		(18,159)	(34,685)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Grantet e pranuar (të arkëtueshme)		14,019	28,215
Grantet e kthyera (grantet e papërdorura)		(161)	-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese		13,858	28,215
Rritja neto në mjete monetare në arkë e bankë		5,713	4,777
Mjete monetare në arkë e bankë në fillim të vitit		9,137	4,360
Mjete monetare në arkë e bankë në fund të vitit		14,850	9,137

Pasqyra e rrjedhes se parase duhet lexuar së bashku me shënime shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 26.

1. Informacion i përgjithshëm

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe tregut (këtej e tutje “Shoqëria” ose “KOSTT J.S.C”) u krijua si një entitet i pavarur më 23 Dhjetor 2005 nga transformimi i “Korporatës Energjetike të Kosovës (“KEK”) dhe u regjistrua si një Shoqëri aksionere sipas rregullores së UNMIK Nr. 2001/6, datë 8 Shkurt 2001 mbi Organizatat e Biznesit (“Rregullorja”) me numër regjistrimi të biznesit 70325350.

Shoqëria zotërohet plotësisht nga Grupi i operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut J.S.C Kosova. Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 datë 13 Qershor, 2008 “Ligji mbi ndërmarrjet publike”, Operatori i Sistemit, transmisionit dhe tregut J.S.C është i zotëruar nga Republika e Kosovës.

Shoqëria nisi veprimtarinë e saj të pavarur në 01 Korrik, 2006 sipas marrëveshjes midis KEK J.S.C dhe KOSTT J.S.C lidhur me marrëdhënien kalimtare, tregtare dhe operacionale midis KEK J.S.C dhe KOSTT J.S.C mbi transferimin e përgjegjësiave mbi operacionet dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Transmisionit të KOSTT J.S.C.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është “ Ndërtesa e shpërndarjes dhe transmetimit, Iljaz Kodra, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Aktivitetet kryesore të shoqërisë janë manaxhimi dhe shfrytëzimi i sistemit të transmetimit të elektricitetit të Kosovës dhe merr përsipër transmisionin e elektricitetit në rrjetet e elektricitetit kryesore me voltazh të lartë. Si një operator tregu, Shoqëria ka përgjegjësi gjithashtu për organizimin dhe administrimin e tregtimit të elektricitetit dhe manaxhon procesin e marrëveshjeve të tilla.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Nuk ka zëra të matura me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro (“EUR”), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. I gjithë informacioni financiar i paraqitur në EUR është përafshuar në mijëshen më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacionet mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare janë përfshirë në shënimin 6 dhe 10.

Gjatë vitit 2010, Shoqëria ka rivlerësuar jetëgjatësinë e aktiveve të caktuara brenda kategorive të instalimeve teknike, pajisjeve dhe makinerive dhe ka ndryshuar normat e zhvlerësimit për disa nga asetet nga 15 vite në 35 vite.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Këto ndryshime janë berë si rezultat i përmiresimeve të rëndësishme të bëra nga kompania për këto aktive, që kanë ndikura në zgjatjen domethënëse të jetëgjatësisë së tyre.

Çmuarjet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktore të tjere, duke përfshirë pritshmëritë për ngjarje të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në varësi të rrethanave.

Politikat kontabël të shprehura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

3. Përmbledhja e politikave kontabël

(a) Monedhë e huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha në datën e raportimit të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos të amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos të amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat e kursit të këmbimit nga rikonvertimi njihen si fitim ose humbje.

(b) Instrumentet financiarë

i. Aktivitet financiare jo të prejardhura

Shoqëria fillimisht njihet llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen. Të gjithë aktivitet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur Shoqëria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivitet financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitet financiar transferohen. Ndonjë interes në aktivitet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë. Aktivitet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivitet dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentet financiarë (vazhdim)

i. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera (vazhdim)

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi. Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme vendoset kur ka tregues të arsyeshëm se Shoqëria nuk do jtë jete e aftë të mbledhë shumat e pritshme sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Vështirësitë financiare të konsiderueshme të debitorit, probabiliteti që debitori do të fillojë procedurat e falimentimit dhe mospagim e shkelje në pagesa (më shumë se 90 ditë vonesë) konsiderohen si tregues që llogaria e arkëtueshme është e humbur.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë gjendjet e mjeteve monetare dhe depozitat në të parë me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Llogaritë debitore bankare që janë të pagueshme me kërkesë dhe që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të menaxhimit të mjeteve monetare të Shoqërisë përfshihen si një element i mjeteve monetare dhe ekuivalentet për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare.

ii. Detyrimet financiare jo të prejardhura

Shoqëria fillimisht i njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare jo të prejardhura të Shoqërisë janë si vijon: llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(c) Aktivet afatgjata materiale

- *Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale të trashëguara para 30 Qershor 2006, data efektive e transformimit, janë transferuar tek Shoqëria me vlerat e tyre kontabël. Aktivet afatgjata materiale janë matur me kosto, pakësuar me zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga humbja e vlerës.

Kosto përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe të punës së drejtpërdrejtë, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për përdorimin e synuar, kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit dhe kostot e kapitalizuara të huave.

3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Aktivët afatgjatë materiale (vazhdim)

Programet e blerë që janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjeve me të cilat lidhen kapitalizohen si pjesë e atyre pajisjeve.

Kur pjesët e një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (pjesë kryesore) të aktiveve afatgjatë materiale. Humbja apo fitimi nga shitja apo nxjerrja jashtë përdorimit e një elementi të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohet duke krahasuar çmimin e shitjes dhe vlerën kontabël të aktiveve afatgjatë materiale dhe njihen për vlerën neto në të ardhura/shpenzime të tjera në fitim ose humbje.

- *Kostot vijuese*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse pritet që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e saj mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjatë materiale njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

- *Zhvlerësimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet me metodën lineare për shpërndarjen e kostos së aktivitetit tek vlera e tij e mbetur përgjatë jetës së tij të dobishme si vijon:

	2010	2009
Tokë, Ndërtesa dhe përmirësime të tokës	20 – 40 vite	20 – 40 vite
Instalime teknike, pajisje dhe makineri	7 - 35 vite	7 - 15 vite
Mjete transporti	5 vite	5 vite
Pajisje zyre dhe kompjuterike	5 vite	5 vite

(d) Aktivët afatgjatë jo-materiale

Aktivët afatgjatë jo-materiale të blerë nga Shoqëria janë paraqitur me kosto pakësuar me amortizimin dhe humbjet e zhvlerësimit të akumuluar. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjatë të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivët specifikë me të cilat lidhet. Të gjitha shpenzimet e tjera janë shpenzime të momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve afatgjatë jo-materiale. Jetëgjatësia e parashikuar është 5 vite.

(e) Inventarët

Inventarët përbëhen nga pjesët e këmbimit, materialet, lëndë djegëse, pajisje dhe material të tjera.

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e kostos mesatare. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur shpenzimet përkatëse të variueshme të shitjes. Materialet dhe pjesët e këmbimit njihen si shpenzime ose kapitalizohen tek aktivët afatgjatë materiale, siç duhet, kur instalohen.

Artikujt në transit vlerësohen me kosto që përfshin vlerën e faturës si dhe i shtohen shpenzime të tjera të akumuluar deri në datën e bilancit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Provizionet

Provizioni është njohur nëse, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, kompania ka detyrime ligjore të cilat mund të maten me besueshmëri, dhe është e mundur që të këtë dalje të parasë që të sjellë përfitime ekonomike të cilat mund të kërkohet të zbatohen me detyrimet. Provizionet janë të përcaktuara nga zvogëlimi i parasë në të ardhmen para normave për tatime të cilat do të reflektojnë në vlersimin e tanishëm të tregut dhe të vlerës së parasë në kohë dhe rreziqeve specifike të detyrimeve. Zbritjetet nga provizionet janë të njohura në shpenzime financiare.

(g) Grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Shoqëria do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të Shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Grantet e qeverisë

Grantet e qeverisë nuk njihen deri kur ka një siguri të arsyeshme që Shoqëria do të plotësojë kushtet që i janë bashkëngjitur atyre dhe grantet do të merren e janë njohur me vlerë të drejtë. Grantet e qeverisë për të cilat kushti fillestar është që Shoqëria duhet të blejë, ndërtojë apo dhe marrë aktive jo materiale njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e bilancit dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë sistematike dhe të arsyeshme përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit përkatës.

Të tjera grante të qeverisë njihen si të ardhura në mënyrë sistematike në periudhat e nevojshme për t'i përputhur me kostot për të cilat synohet të kompensojnë. Grantet e qeverisë që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet apo humbjet tashmë të kryera apo për qëllime të dhënies së mbështetjes financiare të menjëhershme për Shoqërinë, pa kosto të tjera të ardhshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën bëhen të arkëtueshme.

(h) Rënja në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për ranje në vlerë të tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti apo njësi gjenerimi të parasë është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivitetet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavaruara nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (“njësia e gjenerimit të parasë” ose “NGP”).

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e NGP-së së tij tejkalon vlerën e tij të vlerësuar të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NGP-të shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (grupin e njësive) në mënyrë përpjesëtimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(h) Rënja ne vlerë e aktiveve jo-financiare (vazhdim)

zhvlerësimi rimerret vetëm deri në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritet zhvlerësimi ose amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(i) Rënja ne vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se një ngjarje e cila ka sjelle humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivitetet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë mospagimin apo vonesat në pagesë nga debitorët, ristrukturimin e një shumë për t'iu paguar Shoqërisë me terma të cilat Shoqëria nuk do t'i pranonte në një rast të kundërt si dhe treguesit që një debitor ose emetues do të shkojë në falimentim.

Shoqëria konsideron evidencë zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme në nivel specifik dhe kolektiv. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të mëdha vlerësohen në mënyrë specifike për zhvlerësim. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të mëdha që nuk zhvlerësohen në mënyrë specifike, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por që nuk është identifikuar ende. Llogaritë e arkëtueshme individualisht jo të mëdha vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar bashkë llogaritë e arkëtueshme me karakteristika të ngjashme rreziku.

Në përcaktimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor tendencën historike të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar, korrigjuar sipas gjykimit të drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredidhënies janë të tilla që humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Një humbje nga zhvlerësimi i një aktiviteti financiar të matur me kosto të amortizuara llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme monetare të ardhshme skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivitetit. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provizioni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim ose humbje.

(j) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të njësisë ekonomike ku këto flukes hyrëse rezultojnë në rritje të kapitalit dhe jo rritje në sajë të kontributeve të aksionerëve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet.

Kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, Shoqëria i njeh të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara për energjinë e transmetuar (shiko Shënimin 5.2). Shuma e të ardhurave nuk konsiderohet si e matshme në mënyrë të besueshme derisa të jenë zgjidhur të gjitha pasiguritë e lidhura me shitjen. Shoqëria i bazon vlerësimet e saj në rezultatet historike, duke mbajtur parasysh llojin e klientit, tipin e transaksionit dhe specifikimet e çdo marrëveshjeje.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(k) Të ardhura dhe shpenzime nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë interesat e fituara mbi gjendjet e parasë në llogaritë rrjedhëse bankare. Të ardhurat nga interesi njihen ndërsa ndodhin në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(l) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur ka të bëjë me një kombinim biznesesh, ose zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi mbi fitimin i pagueshëm i periudhës përfshin gjithashtu cdo detyrim për taksa që lind nga deklarimi i dividendëve.

Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës për shumën neto ose aktivet dhe pasivet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Një aktiv tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

(m) Përfitimet e punonjësve

- *Fondet e sigurimeve shoqërore, të pensionit dhe të shëndetit*

Sipas legjislacionit të Kosovës në fuqi Shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim i periudhës të cilës i përkasin.

- *Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës*

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Shoqëria është e angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje, ndaj një plani zyrtar të detajuar për përfundim të punësimit para datës së zakonshme të daljes në pension apo që të ofrojë përfitime në përfundim të marrëdhënies së punës si pasojë e një ofertë për të stimuluar largimin vullnetar. Përfitimet në përfundim për largim vullnetar njihen si shpenzim nëse Shoqëria ka

3. Significant accounting policies (vazhdim)

(m) Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

bërë një ofertë për stimulimin e këtij largimi, ka mundësi që oferta të pranohet dhe numri i pranimeve mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

(n) Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e qirave operative (pasi i zbriten stimujt e përfitura nga qiradhënësi) njihen me metodën lineare në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë.

(o) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Disa standarde të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë akoma efektive për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë prej tyre nuk pritet të ketë efekt në pasqyrat financiare të Shoqërisë me përjashtim të:

- SNK 24 i rishikuar, *Paraqitja e Palëve të Lidhura* (efektive për periudhat vjetore të cilat fillojnë në ose pas 1 janarit 2011) paraqet ndryshime që përjashtojnë njësitë ekonomike të lidhura me qeverinë nga shënimet e kërkuara në lidhje me transaksionet e palëve të lidhura dhe balancat e mbetura duke përfshirë angazhimet me (a) një qeveri e cila ka kontroll, kontroll te përbashkët ose influencë të rëndësishme mbi njësinë ekonomike raportuese; dhe (b) një njësi tjetër ekonomike e cila është palë e lidhur sepse e njëjta qeveri ka kontroll, kontroll te përbashkët ose influencë të rëndësishme mbi njësinë ekonomike raportuese dhe njësisë tjetër. Standardi i rishikuar kërkon paraqitje specifike nëse një njësi ekonomike ka avantazhin e këtij përjashtimi. Standardi i rishikuar gjithashtu ka ndryshuar përkufizimin e palëve të lidhura e cila rezultoi në përfshirjen brenda përkufizimit të një marrëdhënie të re, të tilla si, ortakët e aksionerit që ka kontrollin dhe njësisë ekonomike të kontrolluar ose me kontroll te përbashkët nga personeli kryesor. Shoqëria është në process të vlerësimit të ndikimit të IAS 24 të rishikuar në pasqyrat e saj financiare.

4. Drejtimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtëm nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Bordi i Drejtorëve mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e riskut. Bordi ka vendosur procedurën e menaxhimit të riskut të aplikueshme, drejtimi është përgjegjës për zbatimin dhe për të zhvilluar dhe për të monitoruar politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë. Manaxhimi raporton rregullisht për aktivitetet e tij tek Bordi i Drejtorëve.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe menaxhimit të standardeve dhe procedurave, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditit të Shoqërisë vrojton sesi menaxhimi monitoron përputhjen me politikat e procedurat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë dhe rishikon përshtatshmerine e strukturës së menaxhimit të riskut në lidhje me rreziqet që përball Shoqëria. Komiteti i Auditit të Shoqërisë asistohet në rolin e tij të rishikimit nga Audit i Brendshëm. Audit i Brendshëm merr përsipër rishikimi të rregullta ose *ad hoc* të kontrolleve dhe procedurave të menaxhimit të riskut, rezultatet e të cilave raportohen tek Komiteti i Auditit.

4.1 Risku i kredisë

Risku i kredisë është risku që kundërpartia e një instrumenti financiar do të dështojë në riparimin e detyrimeve dhe t'i shkaktojë Shoqërisë një humbje. Instrumentat financiarë, të cilat e ekspozojnë potencialisht Shoqërinë ndaj përqendrimit të riskut të kredisë konsiston kryesisht në të arkëtueshmet. Risku i kredisë i të arkëtueshmeve kontrollohet përmes aprovimeve të të arkëtueshmeve dhe shpenzimeve të buxhetuara që gjenerojnë të tilla të arkëtueshme.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë në biznesin e përditshëm, pasi është e mundur që klientët e saj të mos përmbushin detyrimet e tyre financiare. Shoqëria strukturon nivelet e riskut të kredisë që merr përsipër duke vendosur kufij në shumat e pranuar të riskut në lidhje me kundërpartinë dhe përmes diversifikimit të portofolit të kredisë. Kufijtë në nivelet e riskut të kredisë aprovohen rregullisht nga drejtimi. Riske të tilla monitorohen herë pas here dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë.

Kriza financiare dhe ekonomike botërore e vazhduar ka sjellë, përpos shumë të tjerave, një nivel më të ulët të financimit në tregun e kapitalit, nivele më të ulët likuiditeti në sektorin bankar, dhe, me rastë, norma më të larta të huasë ndërbankare dhe luhatshmëri në tregjet e aksioneve.

Pasiguritë në tregjet financiare ndërkombëtare kanë cuar gjithashtu në falimentime e përvetësime të bankave në të gjithë botën. Shtirja e plotë e impaktit për krizën financiare në vazhdim po tregon se është e pamundur të parathuhet apo të ruhesh në mënyre të plotë ndaj saj.

4. Drejtimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut të brendshëm (tarifat e transmisionit të energjisë), kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive të ardhshme të çmimeve ose ndryshimeve të normave të tregut dhe përbërjes së aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Shoqërisë.

Drejtuesit vendosin kufij mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në bazë mujore. Megjithatë, përdorimi i kësaj metode nuk parandalon humbjet përtej këtyre kufijve në rastin e ndodhjes së lëvizjeve më të mëdha të tregut.

4.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk është ekspozuar ndaj riskut të konsiderueshëm të kursit të këmbimit duke qënë se fondet merren dhe shpenzohen në Euro. Shoqëria nuk përdor instrumenta derivativë për të mbrojtur ekspozimin e saj ndaj riskut të kursit të këmbimit.

4.2.2 Rreziku i normës së interesit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit kryesisht përmes depozitave kohorë dhe interesit të llogarive rrjedhëse në bankë. Shoqëria monitoron ekspozimin, i cili është i lidhur me normat e interesit të tregut, por nuk rrjedh nga norma e interesit të Sëap-eve apo derivative të ngjashëm për mbrojtjen nga risku.

4.2.3 Tarifa e bartjes së energjisë

Sipas modelit aktual të tregut të energjisë, Shoqëria faturon vetëm një tarifë fikse për çdo njësi energjie të bartur. Tarifat e bartjes së energjisë dhe vlerësimi i kërkesës për energji në tregun lokal janë veçanërisht të rëndësishëm për Shoqërinë në këto rrethana.

Çmimet e energjisë që Shoqëria do të jetë në gjendje të zbatojë në lidhje me energjinë balancuese do të jenë objekt i miratimit nga Zyra e Entit Rregullator të Energjisë në Kosovë, duke krijuar në këtë mënyrë rrezik çmimi.

4.3 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që shoqëria do të hasë vështiresi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiar. Shoqëria ekspozohet ndaj kërkesave të përditshme për burimet e lira të parasë, kryesisht për të sistemuar shpenzimet operative të kryera për aktivitetin e përditshëm por edhe për të ripaguar borxhin e saj. Nga ana tjetër, Shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në sistemimin e shitjeve me kredi ndaj kompanisë mëmë për ofrimin e shërbimit të transmisionit të energjisë. Drejtimi monitoron çdo muaj parashikimet e rrjedhëse të parasë së Shoqërisë.

Procesi i adoptuar nga drejtuesit për menaxhimin e likuiditetit përfshin edhe vendosjen e kufizimeve ndaj degëve për shpenzimet në lidhje me aktivitetet e përditshme si shërbimet, furnizimet, investimet, shtyrjen e pagesave ndaj disa kreditorëve ose riskedulimin e marrëveshjeve midis palëve dhe parashikimin e pagesave të kredive duke siguruar që këto të jenë të mbuluara me burimet në dispozicion.

Tabela e mëposhtme tregon detyrimet më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 sipas maturimit të tyre të kontraktuar. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse të

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

4. Drejtimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

kontraktuara të skontuara të parasë, duke përfshirë pagesat e borxhit. Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke iu referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e raportimit.

Më poshtë janë maturitetet kontraktuale të detyrimeve dhe aktiveve financiare, duke përjashtuar ndikimin e sistemit të marrëveshjeve më 31 dhjetor 2010:

	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri ne 10 vjet	Totali
Më 31 dhjetor 2010			
Aktivët			
Të arkëtueshme tregtare	9,390	-	9,390
Parapagime furnitorëve	6,887	-	6,887
Mjete monetare në arkë e bankë	14,850	-	14,850
Total	31,127	-	31,127
Detyrimet			
Detyrimi i tatimit për periudhën	157	-	157
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	8,671	-	8,671
Total	8,828	-	11,595
Pozicioni Neto	22,229	-	22,229
Pozicioni Neto Kumulativ	22,229	-	22,229

Të mëposhtmet janë maturitetet kontraktuale të detyrimeve dhe aktiveve financiare, duke përjashtuar ndikimin e kompensimit të marrëveshjeve në 31 Dhjetor 2009:

	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 10 vjet	Totali
Më 31 dhjetor 2009			
Aktivët			
Të arkëtueshme tregtare	10,202	-	10,202
Parapagime furnitorëve	8,502	-	8,502
Mjete monetare në arkë e bankë	9,137	-	9,137
Total	27,841	-	27,841
Detyrimet			
Detyrim i tatimit të periudhës	481	-	481
Të pagueshme tregtare e të tjera	7,097	-	7,097
Total	7,578	-	7,578
Pozicioni Neto	20,263	-	20,263
Pozicioni Neto Kumulativ	20,263	-	20,263

4. Drejtimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.4 Vlera e drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën mund të shkëmbehet një instrument financiar në një transaksion të zakonshëm mes palëve të mirëinformuara, e që nuk përbën një shitje të detyruar ose likuidim, dhe përfaqësohet më së miri nga një çmim i vlerësuar në një treg aktiv.

Vlera e drejtë e huave dhe llogarive të arkëtueshme konsiderohet se është e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se ato janë instrumente afatshkurtër që nuk bartin interes.

Vlera kontabël e llogarive të pagueshme tregtare e të tjera përafrohet me vlerën e drejtë.

4.5 Menxhimi i kapitalit

Politika e shoqërisë është të ruajë stabilitetin e strukturës së kapitalit për të patur besimin e tregut e kreditorëve dhe për të mbështetur zhvillimin e ardhshëm të biznesit.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashtme për kapitalin

5. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Vlerësimet kontabël dhe gjykimet janë vazhdimisht të vlerësuara dhe të bazuara në eksperiencën e kaluar dhe në faktorë të tjerë, që përfshijnë ngjarje që priten të ndodhin në të ardhmen që mendohet të jenë të arsyeshme në rrethanat e dhëna.

5.1 Vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që lidhen me të ardhmen. Këto vlerësime kontabël, teorikisht, rrallë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një korrigjim material të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar paraqiten më poshtë.

(a) Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë të cilët nuk janë tregtuar në një treg aktiv (për shembull kreditë ndaj punonjësve dhe huatë) përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një numër metodash dhe për të bërë supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet ekzistuese të tregut në çdo datë raportimi. Për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk tregtohen në tregje aktive, Shoqëria përdor analizën e skontimit të flukseve të parasë.

Shoqëria është në procesin e llogaritjes së vlerës së drejtë të këtyre instrumenteve financiare por nuk ishte në gjendje ta bënte këtë para aprovimit të këtyre pasqyrave financiare.

(b) Aktive afatgjata materiale

Drejtimi i Shoqërisë përcakton jetën e pritshme dhe normat e amortizimit për aktivet afatgjata të zotëruara (Shënim 6). Ky vlerësim bazohet në ciklin e jetës së projektuar të aktivit, që mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e tregut. Ndryshimet në jetën e aktiveve, nëse ka, mund të çojnë në korrigjime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël.

5. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

5.1 Vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (huave dhe llogarive të arkëtueshme)

Shoqëria bazohet në udhëzimet e SNK 39 për të përcaktuar se kur një aktiv financiar është i zhvlerësuar. Ky përcaktim kërkon një gjykim të rëndësishëm. Për këtë gjykim, Shoqëria vlerëson, midis faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe nivelin në të cilin vlera e drejtë e një investimi është më e vogël se kosto e tij dhe flukset operative dhe financiare të parasë.

Rishqyrtimi i zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme në vitet e ardhshme mund të çojë në korigjime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël.

5.2 Gjykime kritike në aplikimin e politikave kontabël të entitetit

Tarifat dhe kostot e transmetimit

Të ardhurat nga transmetimi i energjisë njihet në fitim ose humbje bazuar në sasinë aktuale të energjisë të injektuar në rrjetin e shpërndarjes, matur në pikën e dorëzimit dhe duke zbritur humbjet në rrjetin e transmetimit. Të ardhurat nga transmetimi i energjisë u bazuan në marrëveshjen e përkohshme midis KEK J.S.C dhe Shoqërisë për periudhën e përkohshme deri më 31 Dhjetor 2006 me një bazë tarife fikse. Pas kësaj date të ardhurat nga transmetimi i energjisë dhe operator i tregut u bazuan në tarifata e përcaktuara nga Zyra e Rregulltorit të Energjisë (ZRE). Shoqëria pritet të mbajë kostot e lindura në formën e humbjeve teknike në sistemin e transmisionit dhe KEK pritet të mbajë kostot e transmetimit për energjinë e eksportuar për llogari të KEK dhe të paguar nga Shoqëria. Megjithatë, nuk ka marrëveshje formale midis KEK dhe Shoqërisë për sa i përket shpërndarjes së këtyre humbjeve dhe kostove të lidhura me rrjetin e transmetimit gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2009 dhe 2010. Si pasojë KEK mban kostot e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit dhe Shoqëria mban kostot e transmetimit për energjinë e eksportuar për llogari të KEK.

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

6. Aktivet afatgjata materiale

	Toka, ndërtesa dhe përmirësimet e tokës	Instalime teknike, pajisje dhe makineri	Mjete transporti	Pajisje zyre dhe informatike	Ndërtime në proces	Totali
<i>Kosto</i>						
Më 1 janar 2009	23,795	15,279	269	1,000	7,889	48,232
Shtesa	1,753	20,230	2	2,685	10,234	34,904
Transferime	477	7,710	-	4	(8,191)	-
Pakësime	-	(15)	-	(3)	-	(18)
Më 31 Dhjetor 2009	26,025	43,204	271	3,686	9,932	83,118
Më 1 janar 2010	26,025	43,204	271	3,686	9,932	83,118
Shtesa	275	8,454	20	2,130	7,574	18,473
Transferime	58	4,486	-	10	(4,554)	-
Pakësime	-	(26)	-	(7)	-	(33)
Më 31 Dhjetor 2010	26,358	56,118	291	5,819	12,952	101,538
<i>Amortizimi dhe humbjet e akumuluarra nga zhvlerësimi</i>						
Më 1 Janar 2009	(2,419)	(2,267)	(51)	(200)	-	(4,937)
Amortizimi për vitin	(72)	(2,477)	(113)	(324)	-	(2,986)
Amortizimi i pakësimeve	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2009	(2,491)	(4,744)	(164)	(524)	-	(7,923)
Më 1 Janar 2010	(2,491)	(4,744)	(164)	(524)	-	(7,923)
Amortizimi për vitin	(113)	(5,176)	(115)	(604)	-	(6,008)
Amortizimi i pakësimeve	-	-	20	5	-	25
Më 31 Dhjetor 2010	(2,604)	(8,741)	(279)	(1,123)	-	(12,747)
<i>Vlera kontabël neto</i>						
Më 1 Janar 2009	21,376	13,012	218	800	7,889	43,295
Më 31 Dhjetor 2009	23,534	38,460	107	3,162	9,932	75,195
Më 31 Dhjetor 2010	23,754	47,377	12	4,696	12,952	88,791

6. Aktivët afatgjatë materiale (vazhdim)

Nuk ka aktive të lëna si kolateral me 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009.

Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë linjat e transmetimit, nënstacione dhe një qendër të re shpërndarjeje dhe të kontrollit në distancë.

14,196 mijë Euro (2009: 16,209 mijë Euro) të përfshira në shumën totale të shtesave lidhet me zëra të aktiveve afatgjatë materiale të marra përmes granteve. Një shumë e barabartë me amortizimin e vitit për këto aktive prej 1,787 mijë Euro (2009: 887 mijë Euro) është çliruar prej të ardhurave të shtyra dhe është njohur si të ardhura nga grantet në Pasqyrën e të ardhurave përmblendhëse (shih shënimin 13).

Ne Aktivët afatgjatë materiale është përfshirë tokë me vlerë prej EUR 1,595 mijë me 31 dhjetor 2010 dhe 2009, e cila i është kaluar Shoqërisë në kohën kur është bërë ndarja nga KEK në 2006, për të cilën statusi i pronësisë ende nuk është zgjidhur.

7. Aktivët afatgjatë jo materiale

	Programe kompjuterike
Kosto	
Më 1 Janar 2009	76
Shtesa	-
Më 31 Dhjetor 2009	76
Më 1 Janar 2010	76
Shtesa	7
Më 31 Dhjetor 2010	83
Amortizimi dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi	
Më 1 Janar 2009	15
Amortizimi për vitin	15
Më 31 Dhjetor 2009	30
Më 1 Janar 2010	30
Amortizimi për vitin	17
Më 31 Dhjetor 2010	47
Vlera kontabël neto	
Më 1 Janar 2009	61
Më 31 Dhjetor 2009	46
Më 31 Dhjetor 2010	36

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

8. Parapagimet te furnitorëve

Parapagimet ndaj furnitorëve në shumën 6,887 mijë (2009: 8,502 mijë) lidhen me parapagimet e furnitorëve të mallrave dhe shërbimeve të kontraktuar për ndërtimin e aktiveve të transmetimit.

Parapagimet kryesore ndaj furnitorëve më 31 Dhjetor 2010 përfshijnë 1,500 mijë Euro për KFE Bank Group, 5,120 mijë Euro per Siemens AG, 118 mijë Euro per Areva – TD Europa, dhe kanë të bëjnë me ndërtimin e nënstacionit prej 400/110KV Ferizaj 2 dhe projektin e kompjuterizimit të SCADA.

Parapagimet kryesore ndaj furnitorëve më 31 Dhjetor 2009 përfshijnë: 5,280 mijë Euro per Siemens AG për projektin e rehabilitimit të SS 220/110 KV Kosova A; 2,219 mijë Euro per konsorciumin AREVA & ENERGOINVEST për ndërtimin e nënstacionit të ri Ferizaj 2 400/110 KV, dhe 484 mijë Euro ndaj KOMETEL për projektin e kompjuterizimit të SCADA.

9. Inventarët

Gjendjet e inventarit më 31 Dhjetor 2010 dhe 2009 përbëhen nga:

	2010	2009
Pjesë këmbimi	704	837
Materiale	297	266
Lëndë djegëse	27	29
Të tjera	66	38
Provizjone të inventarit	(186)	(154)
Total	908	1,016

10. Të arkëtueshme dhe të tjera

	2010	2009
Të arkëtueshme nga KEK J.C.S	10,447	8,289
Të arkëtueshme të tjera	109	9
TVSH e arkëtueshme	1,891	1,902
Të tjera të arkëtueshme	-	2
Provizione të arkëtueshmeve	(3,057)	-
Total	9,390	10,202

Më 31 Dhjetor 2010, të arkëtueshmet prezantohen neto nga një provizion për borxhin e keq prej 3,057 mijë Euro (2009: nil Euro) që lindin prej rakordimit të kryer me KEK për vitet 2008, 2009 dhe 2010, të cilat KEK refuzon t'i paguajë. EUR 933 mijë, EUR 1,465 mijë dhe EUR 659 mijë nga ky provizion ju përkasin të hyrave nga transmisioni i energjisë për vitet 2010, 2009 and 2008, respektivisht.

11. Mjete monetare në arkë e bankë

	2010	2009
Mjete monetare në bankë	14,849	9,137
Mjete monetare në arkë	1	-
Total	14,850	9,137

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

12. Kapitali Aksioner

	2010	2009
Kapitali aksioner i zakonshëm	25	25
<i>Prime të aksioneve jo në mjete monetare</i>		
Aktive afatgjata materiale	27,839	27,839
Inventarë	493	493
Tokë e marrë nga KEK në Podujevë	15	15
	28,347	28,347
Total	28,372	28,372

KOSTT Holding J.S.C, një shoqeri aksionere, zotëron 100 % të kapitalit aksioner të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2010 dhe 2009, zotëruesi final i KOSTT J.C.S është Qeveria e Republikës së Kosovës. Në datën efektive të korporatizimit më 1 Korrik 2006, KEK J.S.C transferoi tek KOSTT J.S.C disa aktive me vlerën e tyre kontabël sipas marrëveshjes midis KEK J.S.C dhe KOSTT J.S.C.

13. Grantet

	2010	2009
Gjendja më 1 Janar	57,362	30,038
Grantet e marra gjatë vitit	14,014	28,215
Amortizimi vjetor i granteve	(1,828)	(890)
Mjete monetare të paguara në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës	(123)	-
Pakësim i arkëtimeve të granteve	(38)	(1)
Gjendja më 31 Dhjetor	69,392	57,362

	2010	2009
Aktive afatgjata materiale	68,419	56,711
Inventarët	613	651
Total	69,392	57,362

	2010	2009
Zhvlerësimi i pajisjeve	1,787	887
Zhvlerësimi i programave kompjuterike	3	3
Inventarët	38	-
Total	1,828	890

Grantet lidhen me fonde apo aktive nga qeveria e Kosovës apo donatorë të tjerë të lidhur me aktivitetet e Shoqërisë.

Grantet e shtyra përfshijnë parapagime për projekte të rëndësishme, të cilat janë në proces ndërtimi dhe projekte të ardhshme madhore, të cilat nuk kanë filluar ende, duke përfshirë dhe projektet e mëposhtme: Peja 2, Peja 3, Kosova A, SCADA, Njesoret, Prishtina 1&2, Vushtria, Vushtria 2, Rahoveci, dhe Glogovc.

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

14. Të pagueshme tregtare dhe të tjera

	2010	2009
Kreditorë të huaj		
Elektroprivreda Serbije - EPS	3,177	1,577
Elektromerza Serbije - EMS	1,038	1,038
Siemens AG	833	1,253
Të tjera	791	417
	5,839	4,285
Kreditorë lokalë		
Korporata Energjitike e Kosoves (KEK J.S.C)	1,885	1,631
Detyrime nga punonjësve	190	206
Tatim fitim i pagueshëm	52	-
Të tjera	705	975
	2,832	2,812
Total	8,671	7,097

Llogaritë e pagueshme afatshkurtra për aktivet afatgjata materiale lidhen kryesisht me punimet dhe materialet e furnizuara, dhe të pagueshme në vitin pasardhës.

15. Të ardhura

	2010	2009
Të ardhura nga transmisioni i energjisë - KEK J.S.C	20,076	19,875
Të ardhura nga operimet e tregut	-	186
Total	20,076	20,061

16. Të ardhura të tjera

	2010	2009
Të ardhura nga grantet	2,055	890
Të ardhura të tjera	293	87
Total	2,348	977

17. Shpenzime personeli

	2010	2009
Shpenzime personeli	2,522	2,174
Detyrime për tatim mbi të ardhurat dhe pensionet	126	109
Pagat e kontraktuara të punonjësve	88	55
Total	2,736	2,338

Numri i punonjësve	213	214
--------------------	-----	-----

18. Riparime dhe mirëmbajtje

Riparime dhe mirëmbajtje prej 752 mijë Euro (2009: 918 mijë Euro) lidhet me riparime dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe rrjeteve të transmisionit.

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

19. Shpenzime të tjera operative

	2010	2009
Provizioni i të arkëtueshmeve	2,765	-
Shpenzime kërkimore dhe analizash	208	-
Shpenzime udhëtimi dhe akomodimi	207	241
Shpenzime të ruajtjes së sigurisë	205	174
Shpenzime materiale zyre dhe inventar i imët	141	120
Të tjera shpenzime	128	38
Shpenzime shërbimesh	116	225
Shpenzime marketingu dhe përfaqësimi	114	53
Shpenzime trajnimi	86	100
Shpenzime të taksa të pronësise dhe taksa të tjera	47	37
Shpenzime mjekësore	45	23
Provizion për inventar të vjetër	32	154
Shpenzime sigurimi për automjetet dhe të tjera	12	68
Nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve	8	17
Komisione bankare	6	8
Shpenzime anëtarësimi	1	-
Total	4,121	1,258

20. Të ardhura nga interesi

	2010	2009
Të ardhura nga interesi	301	219
Total	301	219

Llogaria rrjedhëse me bankën mbart interes në normat vjetore 2.60% deri në 2.80% gjatë vitit të mbyllur me 31 Dhjetor 2010 (2009: 2.60%).

21. Tatim mbi fitimin

	2010	2009
Tatimi mbi fitimin e periudhës	657	522
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	16	169
Total i tatimit mbi fitimin	673	691

Tatimi i periudhes ne fitim dhe tatimi i shtyre me 31 Dhjetor 2010, janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Detyrimet për tatim fitimin e periudhës	157	481
Detyrimet për tatim fitimin e shtyrë	185	169
Total	342	650

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

21. Tatim mbi fitimin (vazhdim)

Detyrimi për tatim fitimin e shtyrë lidhet me diferenca të përkohshme të zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale, të cilat kontabilizohen ndryshe për IFRS dhe raportim për taksa.

Tatimi mbi fitimin para tatimit të Shoqërisë ndryshon nga shuma teorike që do të lindë duke përdorur normën tatimore mesatare të ponderuar që zbatohet ndaj fitimeve të Shoqërisë:

Rakordimi i normës efektive të tatimit	Norma e tatimit	2010	Norma e tatimit	2009
Fitimi para tatimit		4,141		7,455
Tatimi i përlogaritur me 10%	10.00%	414	10.00%	746
Efekt i shpenzimeve të panjohura diferenca të përhershme	6.24%	259	1.59%	118
Efekt i humbjes së sjellë	0.00%	-	(2.32%)	(173)
Total fitimi i periudhës	16.24%	673	9.26%	691

Aktivitetet dhe detyrimet e tatim fitimit të shtyrë netohen kur ka një të drejtë ligjore për të shlyer aktivin e tatim fitimit të periudhës ndaj detyrimeve të tatim fitimit të periudhës dhe atëherë kur tatim fitimi i shtyrë lidhet me të njëjtin autoritet fiskal. Tatimi i shtyre llogaritet bazuar në normën e miratuar të tatimit prej 10 % (2009: 10%)

Lëvizja bruto në llogarinë e tatim fitimi të shtyrë është si më poshtë:

	2010	2009
Fillimi i vitit	169	-
Lëvizja në diferencat e përkohshme	16	169
Total fitimi i shtyrë 31 Dhjetor	185	169

22. Transaksionet me palët e lidhura

Shoqëria kontrollon nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Kosovës, e cila zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë. KEK Sh.a është po ashtu në pronësi të shtetit dhe konsiderohet palë e lidhur së bashku me Ministrinë e Financave dhe Menaxhmentin kryesor.

Transaksionet e mëposhtme janë kryer me palët e lidhura:

<i>(a) Shitje shërbimesh:</i>	2010	2009
Shitje shërbimesh:		
KEK J.S.C	20,076	20,061
Kosto shërbimesh:		
KEK J.S.C	4,319	5,212

Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT J.S.C
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2010
 (në EUR)

22. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

(b) Shpërblimi i drejtuesve kryesorë

	2010	2009
Paga dhe shpërblime të tjera afatshkurtra për punonjësit	468	429
Këshilli mbikëqyrës	73	38
Total	541	467

(c) Grante nga palët e lidhura

	2010	2009
Ministria e Ekonomise dhe Financës	68,684	57,362
Total	68,684	57,362

23. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

(i) Te hyrat nga Elektromreza e Serbise

Më 31 Dhjetor 2010, Shoqëria ka fatura të hapura për transmisionin e energjisë në transit prej EUR 10,737 mijë me Elektromreza Serbije (EMS) për kompensimin e transimit të elektricitetit, EUR 1,464 mijë prej të cilave kanë të bëjnë me transmetimin në vitin 2010 (2009:EUR 9,273 mijë), të cilat nuk kanë qenë të regjistruara në të hyra për vitet 2009 dhe 2010.

Faturimi është berë mbi llogaritje të bazuara në Marrëveshjen e Përkohshme për Shkëmbimin e Energjisë midis Departamentit të Punëve Publike të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) si përfaqësuese e KEK (Kompania e Energjisë së Kosovës) dhe Ministrisë së Energjisë dhe Ministrisë së Republikës së Serbisë si përfaqësuese e EPS (Industria e energjise elektrike të Serbisë) për blerjen, shkëmbimin, asistencën, transimitin dhe matjen e energjisë. Mbi këtë bazë KOSTT JSC ka faturuar prej Korrikut 2004 tek EMS, pasuesi i EPS, transimitin e bërë prej territorit të Republikës së Kosovës. Matja e transimitit të energjisë nga Serbia në vende të tjera duke përdorur sistemin e transmisionit të KOSTT, është bërë me sistemin matës të KOTT dhe nuk është rakordua me sistemin e matjes të EMS.

Prej Korrik 2004 të gjitha Shtetet e Europës Jug-Lindore kanë aplikuar ITC (Kompensimin e Ndërtransmetimit) mekinizëm i shumë anshëm, i cili lejon çdo vend të tarifoje për transimitin e bërë prej atij vendi. Kompania e energjisë së Kosovës, KEK, nuk ka qene prezente në nëshkrimin e kësaj marrëveshje për shkak të arsyeve politike.

Kompania ka kontabilizuar shpenzimet për shumën 1,600 mijë EUR (2009: 996 mijë EUR) ndaj EMS për rregulloren dytësore “Kontrolli i frekuencës së ngarkesës elektrike, Rezervës dhe asistencës së emergjencës dypalëshe”. Kompania ka kontabilizuar këtë bazuar në kontratën e nënshkruar midis Departamentit të Punëve Publike të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) në Kosovë dhe Ministrisë së Energjisë dhe Ministrisë së Republikës së Serbisë datë 26 Mars 2001. Shërbimet janë ofruar nga EPS deri në Maj 2008 nga kjo datë EMS si pasues i EPS po i siguron këtë shërbim KOSTT. Shoqëria ka ndaluar pagimin e tarifës ndaj EPS prej Shtatorit 2007. Me 31 Dhjetor 2010 Kompania ka EUR 4,215 mijë të pagueshme ndaj EPS (31 Dhjetor 2009 EUR 2,615 mijë).

Menaxhmenti nuk mendon se do të marrë të ardhura nga shumatat e faturuara për shkak të çështjeve politike midis Kosovës dhe Serbisë. Për elementin e shpenzimeve drejtimi beson se shërbimet ofrohen nga EMS dhe ka shans të lartë që këto shuma do paguhen. KOSTT ka ngritur një ankesë tek entitet rajonale nga të cilat varen të dy palët dhe ka lëshuar fatura njëkohësisht me qëllim që të provojë/dokumentojë pretendimin.

23. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

(i) Te hyrat nga Elektromreza e Serbise (vazhdim)

Gjithsesi e ardhura nga transiti i energjisë, bazuar në Metodologjinë Tariff nuk i përket KOSTT dhe duhet të kthehet tek klientët atëhere kur të merret. Kjo çështje nuk është zgjidhur ende midis Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Për arsyen e përmendur me sipër Bordi i Drejtorëve ka vendosur të paraqesë si aktive të mundshme, dhe të mos i përfshijë në Pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

(ii) Te hyra nga KEK

Ne te hyra me fund viti 31 dhjetore 2010 jane te përfshira edhe shumat prej EUR 933 mije (2009: EUR 1,465 mije) qe kane te bëjnë me te hyrat shtesë që vinë si rezultat i harmonizimit të të hyrave ndermjet KEK dhe KOSTT per transmisionin e energjise per vitin 2009 dhe 2010, te cilat KEK refuzon ti paguajë. Duke pasurparasysh pasigurinë që ka te bëjë me keto shuma, Shoqeria ka bërë provizion ndaj tyre ne vitin 2010, ne shumen prej EUR 3,057 mijë, përvec harmonizimeve per vitet 2009 dhe 2010, kjo shume përfshin edhe harmonizimet per te hyrat e viti 2008 ne shumen prej 659 mije. Shiko note 10.

Të përfshira në të hyra janë EUR 4,814 mijë të faturave të rregullta me KEK për transmisionin e energjisë për muajt nëntor dhe dhjetor 2010. Këto fatura janë të gjeneruara në bazë të tarifave të lëshuara nga ZRE në fillim të vitit. KEK ka refuzuar të paguajë keto fatura për shkak se te hyrat e realizuara gjatë vitit kanë kaluar ato të buxhetuara si rezultat i transmisionit të sasisë më të lartë të energjisë, përfshirja e këtyre shumave do të shkaktojë tejkalimin e të hyrave nga transmisioni në raport me ato që janë buxhetuar në fillim të vitit. Shoqeria ka bërë ankesë tek ZRE dhe është e bindur se ajo shumë duhet të paguhet nga KEK meqenese faturat janë në baze të tarifave për kilowat të përcaktuara nga ZRE që në fillim të vitit. Për këtë shkak Shoqeria nuk ka bërë shlyrje të këtyre shumave në pasqyra financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2010.

(iii) Çështje gjyqësore

Në 31 Dhjetor 2010, ka çështje gjyqësore te ngritur kundër Shoqërisë me një total 310 mijë Euro (31 Dhjetor 2009: 119 mije Euro). Nuk është bërë provizionim, pasi këshillimi profesional tregon se nuk ka gjasa që të lindë ndonjë humbje e konsiderueshme. Në të ardhmen veprime dhe pretendime të ndryshme ligjore mund të ngrihen ndaj Shoqërisë për incidente gjatë aktivitetit të përditshëm të biznesit. Edhe pse rezultatet e këtyre çështjeve nuk mund të përcaktohen gjithmonë me saktësi, drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë çështjeje e cila do të kete efekt të konsiderueshëm financiar për Shoqërinë.

24. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit e cila mund të kërkojë rregullim ose shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.